



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË
Komiteti për Politikë dhe Financa
I. Numër: 01-060-01-14309
Pejë, me datën: 18.02.2022



PROCESVERBAL

Nga takimi i II-të i Komitetit për Politikë dhe Financa i K.K., në Pejë, mbajtur me 18 shkurt 2022, në orën 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesues, z. Rexhep Kurtbogaj; znj. Arta Vokshi-Nallbani, Drejtoreshë e Urbanizmit; znj. Xhenet Syka Kelmendi, Drejtoreshë e , DKRS ; z. Arianit Krasniqi, Drejtor i DÇPJ; z.Tahir Shala, Drejtor i Bujqësisë,; z. Sabhudin Cirikovic, shef i Zyrës për komunitete; z. Pandeli Rugova, shef i Zyrës Ligjore; z. Avni Gashi, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit; z. Egzon Kastrat Asistent Administrativ i Kryesuesit dhe përfaqësuesit e ZIP-it.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili konstatoi se jemi tetë anëtarët prezent. Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin për rendin e ditës, ku i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend dite.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Materialin për këto pika të rendit të ditës e keni marrë paraprakisht në email me kohë.

Unanimisht nga të gjithë që ishin prezent u miratua ky:

REND DITE

- 1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**
- 2. Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i Komitetit për Politikë dhe Financa: dt. 20 janar 2022.**
- 3. Raportet dhe rekomandimet e dhëna nga Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtoritë e SHCK-së:**
 - 3.1. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Plani i Punës i Zyrës për Komunitete.
 - 3.2. Shqyrtimi i propozimit të DKRS-së për dhënien e Autorizimit DKRS-së, për publikimin e konkursit publik për tituj nderi, dhënien e dekoratave dhe titujve të tjerë.
 - 3.3. Shqyrtimi i propozimit të DKRS-së për formim nga ana e Kuvendit Komunal në Pejë, të komisionit të veçantë për ndarjen e titujve të nderit, dhënien e dekoratave dhe titujve tjerë.
 - 3.4. Shqyrtimi i DBPH-së për themelimin e Vendgjuetive në Komunën e Pejës.
 - 3.5. Shqyrtimi i raportit vjetor 2021 i Ekzekutivit Komunal të Pejës.
 - 3.6. Informatë mbi realizimin e Planit të Prokurimit për vitin paraprak 2021.
 - 3.7. Informatë mbi procesin e legalizimit të objekteve.
 - 3.8. Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimëve dhe objektivave të PZHK-së, PU-së dhe PRR-së për vitin paraprak.
 - 3.9. Formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për hapësirat publike, të ish shkollës së artit "Odhise Paskali".
 - 3.10. Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të ish Shkollës së Artit "Odhise Paskali".
 - 3.11. Formimi i komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv-drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare në Komunën e Pejës.

3.12. Shqyrtimi i propozimit për shpalljen e interesit publik në Kapeshnicë.

3.13. Propozimi i kryetarit për zëvendësimin e anëtarit të KKS- së

4. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët në atë renditje siç janë pranuar.

I.

Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Mungoi: Xhevahir Çeku – Kelmendi.

II.

Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i Komitetit për Politikë dhe Financa: dt. 20 janar 2022.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent, u miratua procesverbali i takimit të Komitetit për Politikë dhe Financa i dates: 20 janar 2022.

III

Raportet dhe rekomandimet e dhëna nga Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtoritë e SHCK-së:

3.1. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Plani i Punës i Zyrës për komunitete.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Pika e parë e rendit të ditës është shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Plani i Punës i Zyrës për Komunitete. Materialin e keni marrë, këtu me ne është z. Cirkovic për të dhënë detaje shtesë lidhur me këtë raport.

z. Sabhudin Cirikovic: siç edhe e keni marrë materialin, aty janë të definuara të gjitha aktivitetet e zyrës, desha vetëm në pika të shkurtëra, me qenë se është takimi i parë të ju orientoj diçka që është me rëndësi, zyra për komunitete dhe kthim përbëhet prej dy pjesëve, pjesa për kthim dhe riatdhesim. Pjesa për kthim merret me persona të zhvendosur brenda Kosovës dhe tri shteteve fqinje: Serbisë, Maqedonisë, Malit të Zi. Pjesa e dytë që merret me persona të riatdhesuar, janë personat që kthehen prej shteteve evropiane me dhunë, diku me 95% janë me sjellje problematike aty ky gjinden. Në material nuk ekzistojnë shifrat por për kthim po përmendi se kemi pasur vështirësi në aktivitete për shkak të kovidit, sepse hapi i parë është vizita ku ata janë: Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi. Ndërsa te riatdhesimi i keni tabelat përpara që janë të nivelit qendror, ku janë 15 familje me 27 anëtarë, pa kryefamiljar. Te Mali i Zi është e rëndësishme të ceket se është e dyfishtë edhe për kthim, por edhe Kosova ka marrëveshje për riatdhesim, por në përgjithësi riatdhesimi lidhet me ministri të punëve të brendshme. Personat që riatdhesohen kanë të drejtë me përfitu ushqim, dru nëse janë gjatë dimrit dhe akomodim deri në një vit, renovim por jo ndërtim shtëpiave, në këtë program përfitojnë të gjithë personat që kanë qëndruar jashtë mbi një vit. Tani Zyra për Komunitete merret edhe me personat që vijnë azil, por vetëm pasi që ta marrin statusin e azilit. Më tutje z.Cirkovic shpjegoi edhe detaje të tjera para anëtarëve lidhur me raportin vjetor të punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe planin e Punës e Zyrës për Komunitete si pikë të rendit të ditës.

Znj. Zize Hakaj-Veselaj: këto familje që kthehen a kanë tokë dhe shtëpia, apo krejtve duhet me ju siguru drutë e akomodimin e senet tjera?

z. Sabhudin Cirikovic: shumica e familjeve e kanë pronën (tokën), ka disa që kanë shtëpi pastaj ato rinovohen diku 3 mijë - 5 mijë euro është shuma, por për këtë vendosin komisionet qendrore. Deri në 1 vit këto familje përfitojnë pagesën e qirasë, mbasë një viti kalojnë te drejtoratet sociale.

Unanimisht u votua nga të gjithë anëtarët prezent që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, raporti vjetor i punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Plani i Punës i Zyrës për Komunitete.

3.2. Shqyrtimi i propozimit të DKRS-së për dhënien e autorizimit DKRS-së, për publikimin e konkursit publik për tituj nderi, dhënien e dekoratave dhe titujve të tjerë.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Pika tjetër e rendit të ditës është, shqyrtimi i propozimit të DKRS-së për dhënien e autorizimit DKRS-së, për publikimin e konkursit publik për tituj nderi, dhënien e dekoratave dhe titujve të tjerë. Materialin e keni marrë paraprakisht, këtu kemi drejtoreshën e DKRS – së për sqarime shtesë.

Znj. Xhenet-Syka-Kelmendi: Meqenëse shumica e anëtarëve të komitetit janë anëtarë të rinj, unë kam sjell rregulloren Nr. 02/2016 për tituj të nderit, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime. Meqenëse rregullorja është nxjerr nga Komuna e Pejës, janë ndërmarrë me kohë veprimet për autorizim, janë bërë të gjitha përgaditjet administrative, logjistike që janë në harmoni me këtë rregullore për të mos pasur asnjë devijim gjatë debatit. Të gjitha detajet tjera i keni bukur të shkruara në rregullore, DKRS-ja e sponzorizon në aspektin administrativ dhe logjistik këtë proces.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: kjo pikë është vetëm për autorizim jo komision.

Me shtatë vota pro dhe një i përmbajtur, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimin e DKRS-së për dhënien e autorizimit DKRS-së, për publikimin e konkursit publik për tituj nderi, dhënien e dekoratave dhe titujve tjerë.

3.3. Shqyrtimi i propozimit të DKRS-së për formim nga ana e Kuvendit Komunal Pejë, të Komsionit të veçantë për ndarjen e titujve të nderit, dhënien e dekoratave dhe titujve tjerë.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: kjo pikë ka të bëjë me formimin e komisionit të veçantë për ndarjen e titujve të nderit, dhënien e dekoratave dhe titujve të tjerë. Komisioni ka 7 anëtarë për anëtarë, 5 anëtarë të Kuvendit zbatohet formula e pjesëmarrjes nga numri i anëtarëve të partive në Kuvend, një nga drejtoria përkatëse dhe një anëtar nga shoqëria civile. Kryesuesi i komisionit zgjidhet një anëtar nga kuvendi.

z. Berat Ganiqi: A duhet patjetër me qenë anëtar i kuvendit për me qenë anëtar i komisionit, për shkak se në kuvend s'mundesh me pas njerëz adekuat për zgjedhje. Sepse ne si grup s'kemi asnjë anëtar të fushës. Mendoj që duhet me njoftë fushën e jo të jepen si herave të kaluara, i takon një subjekti edhe po ja jepim.

Znj. Xhenet-Syka-Kelmendi: Statuti e përcakton se anëtarët e komisionit duhet të jenë anëtarë të Kuvendit dhe besoj që janë të denjë për ta vlerësuar proceduralisht procesin. Rendom dy apo tri propozime gjithmonë kanë ardhur nga KPF-ja. Është mirë me i pas emrat sa ma shpejt sepse konkursi mbetet i hapur një muaj.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Komisioni e vlerëson anën ligjore dhe meritore të atyre kandidatëve në harmoni me rregulloren.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet Kuvendit, shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DKRS-së për formim nga ana e Kuvendit Komunal Pejë, të Komsionit të veçantë për ndarjen e titujve të nderit, dhënien e dekoratave dhe titujve të tjerë.

3.4. Shqyrtimi i DBPH-së për themelimin e Vendgjuetive në Komunën e Pejës.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Kjo pikë ka të bëjë me shqyrtimin e DBPHH-së për themelimin e vendgjuetive në komunën e Pejës. Materialin e keni marrë paraprakisht, mandatin e kaluar është marrë një vendim nga kuvendi para marrjes së pelqimit nga ministria përkatëse, tani e kemi pëlqimin nga ministria, drejtoria përkatëse e kanë pa të arsyeshme tani me pru në kuvend.

z.Tahir Shala: siç e potencoj edhe kryesuesi ne kemi marrë një vendim mandatin e kaluar por që është shpall i jashtëligjshëm për shkak të mos marrjes paraprake të pëlqimit nga ministria përkatëse ndërsa tani e kemi atë pëlqim. Ne si komunë jemi të vonuar në këtë drejtim, sepse duhet të qesim në ankand dhe shoqatat të aplikojnë sepse ato pos që e përdorin si rekreacion, janë edhe mbrojtëse të këtyre vendgjuetive. Deri me tani çdo gjueti që është zhvilluar është ilegale. Shpresoj që të miratohet kjo sot sepse gjithçka është në rregull sipas procedurave.

Me shtatë vota pro dhe një i permbajtur, i rekomandohet kuvendit, shqyrtimidhe miratimi i DBPHH-së për themelimin e vendgjuetive në komunën e Pejës.

3.5. Shqyrtimi i raportit vjetor 2021 i Ekzekutivit Komunal të Pejës.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Kjo pikë është raport informativ lidhur me punën e ekzekutivit të komunës së Pejës për vitin 2021, për shkak të një takimi kryetari s'mundet me qenë prezent, materialin ju kemi dërguar me kohë, ky raport kalon edhe nga kuvendi.

Znj. Zize Hakaj-Veselaj: Unë kisha dashur të ndërlidhna te raporti për shëndetësi, po e shoh që e keni hap një konkurs me daten 08.04.2021, mjekë specialist nga protektika stomatologjike që besoj është pranë për polikliniken nelt. Kemi një kërkesë, që 5 vjet e kemi karriken stomatologjike në ambulanten në Raushiq me hap një konkurs për stomatolog.

Znj. Myrvete Salihu : Përgjigjen do ta marrësh në kuvend krejt janë të planifikuara.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent, i rekomandohet kuvendit si raport informativ shqyrtimi i raportit vjetor 2021 i ekzekutivit të komunës së Pejës.

3.6. Informatë mbi realizimin e Planit të Prokurimit për vitin paraprak 2021.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Edhe ky është raport informativ qe kish mujt kryetari me shtjellu me shumë, materialin e keni marrë me kohë lidhur me këtë pikë.

Znj. Zize Hakaj-Veselaj: Materialin e kemi marrë por ka qenë shumë e vështirë me lexu për shkak që tabelat kanë qenë tepër të vogla, shpresoj që kjo të rregullohet herave të tjera.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Ky plan është i realizuar mirë brenda kritereve që i ka pas.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent u votua që t'i rekomandohet kuvendit, shqyrtimi i informatës mbi realizimin e planit të prokurimit për vitin paraprak 2021.

3.7. Informatë mbi procesin e legalizimit të objekteve.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Ky raport është informatë mbi procesin e legalizimit të objekteve, materialin e kemi marrë me kohë.

Znj. Arta Nallbani: Materialin e keni marrë në pika të shkurtëra, do ta bëjë një përmbledhje të raportit. Kërkesa për legalizim gjatë vitit 2021 kanë qenë 313, ku 167 prej tyre janë pajisur me certifikatë të legalizimit, ndërsa 146 janë në proces. Me tutje znj. Nallbani në mënyrë të detajuar e shpjegoj procesin e legalizimit.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit, shqyrtimi i raportit informativ rreth legalizimit të objekteve.

3.8. Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të PZHK-së, PU-së dhe PRR-së për vitin paraprak.

Znj Arta Nallbani: Materialin e keni marrë, s'kisha dasht me u ndal shumë, është plan veprimi në kuadër të planit zhvillim ose komunal 2020 – 2028, ku përfshihen të gjitha punët që janë krye dhe që kanë me u krye.

Znj. Zize Hakaj- Veselaj: Po e shoh një fushë ndihmëse se u mbaru në Raushiq, s'po di ku është ajo fushë.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent me vërejtjet që u dhanë, i rekomandohet kuvendit, shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të PZHK-së, PU-së dhe PRR-së për vitin paraprak.

3.10. Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim ish Shkollën e Artit “Odhise Paskali”.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Në këtë pikë po e shqyrtojmë vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të ish shkollës së artit “Odhise Paskali”.

Z. Arianit Krasniqi: Në kuadër të planit zhvillimor komunal, është paraparë që ky objekt të i'u jepet në shfrytëzim të gjithë atyre që promovojnë, informatikën, robotikën, kodimin etj. Pra bëhet fjalë për një vendim paraprak.

Z. Berat Ganiqi: Komisionin e kaluar që e kemi votuar a hyn edhe kjo ?

Z. Arianit Krasniqi: Jo, për secilin vendim duhet ni komision ad-hoc, për çështje të vlerësimit gjithmonë zgjidhet një komision i ri. Ndërsa komisioni i ankesave ka mandat 2 vjeçar.

Z. Berat Ganiqi : Herën e kalume kryetari ka thënë që kemi me formu ni komision për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike, një ndër to e ka përmend edhe këtë shkollën “Odhise Paskali”.

Z. Pandeli Rugova : Ligji për dhënien e pronave në shfrytëzim e përcakton se komisione vlerësuese janë ad- hoc, ndërsa komisionet e ankesave me mandat dy vjeçar.

Z. Labinot Panxha: Çka bon ky komision ma shumë se i pari, rregullorja e thotë qartë veç nëse doni me nxjerrë vendim mbi vendim. Një listë të pronave që e kemi votu në kuvend e kemi formu ni komision për dhënien në shfrytëzim të tyre.

Z. Pandeli Rugova : Duhet pos konkluzionit të bëhet edhe draft- propozimi nga zyra e kryetarit.

Z. Avni Gashi : Materialin që na ka ardh është draft-vendimi me një konkluzion nga zyra e kryetarit që sot e kemi për trajtim në Kpf, kjo o praktika që aplikohet.

Me 4 vota pro, 1 kundër dhe 3 të përmbajtur i rekomandohet kuvendit, shqyrtimi i vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të ish shkollës “Odhise Paskali”.

3.9. Formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për hapësirat publike ish shkolla e artit “Odhise Paskali”

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Në këtë pikë do të diskutohet për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për hapësirën publike të ish shkollës së artit “Odhise Paskali”, për çdo pronë që jepet në shfrytëzim formohet një komision i veçantë ndërsa komisioni për ankesa është me mandat dy vjeçar. Komisioni ka pesë anëtarë, dy janë nga kuvendi, dy nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile. Anëtarët e kuvendit propozohen sipas formulës së pjesëmarrjes së subjekteve me anëtarët në kuvend.

Me katër vota pro, katër të përmbajtur i rekomandohet kuvendit, shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për hapësirat publike ish shkolla e artit “Odhise Paskali”.

3.11. Formimi i Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv-drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare në K. e Pejës.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Në këtë pikë kemi dominimin e komisionit për zgjedhje të drejtorëve dhe zv- drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare në K. e Pejës. Materialin me emrat e propozuar i kemi marrë nga drejtoria për arsim është propozu znj. Shqipe Karagjyzi, këshilli i prindërve Qevsere Grapci dhe një që e propozon ministria e linjës.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit, shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për formimin e Komisionit për Zgjedhjen e drejtorëve dhe zv-drejtorëve të institucioneve edukativo- arsimore dhe aftësuese parauniversitare në K. e Pejës.

3.12. Shqyrtimi i propozimit për shpalljen e interesit publik në Kapeshnicë.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: Kjo pikë ka të bëjë me shqyrtimin e propozimit për shpalljen e interesit publik në Kapeshnicë, materialin e kemi marrë, drejtorin e kemi prezent për sqarime shtesë.

Z. Arianit Krasniqi: Ky propozim ka të bëjë me krijimin e një hapësire që paraprakisht ngjitur me parcelat që do të propozohen siç i shihni edhe ju në material, këtë shtëpi e kemi rrënu edhe është kriju një hapësirë prej gati 5 ari. Bëhet fjalë për katër parcela me dy pronarë ne e shpallim me interes publik për krijimin e një parkingu për lagjen, kënd të lojërave dhe hapësirë gjelbëruese, kur të realizohet ky plan krijohet një hapësirë gati 12 ari të dëstinuara si më lartë.

Z. Berat Ganiqi: A ka me u bo këmbim apo shpronësim, se njëri prej pronarëve qenka ni kompani që merret me ndertim.

Z. Arianit Krasniqi: Jo ne vetëm kemi me shpall interes publik njëherë, pastaj janë procedurat tjera.

Me pesë vota pro dhe tri të përmbajtura i rekomandohet kuvendit, shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për shpalljen e interesit publik në Kapeshnicë.

3.13. Propozimi i kryetarit për zëvendësimin e anëtarit të KKSB- së

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: E kemi edhe këtë pikë që e kemi lanë për fund për shkak të një gabimi teknik që është bërë gjatë pranimi të dokumentacionit për anëtarin e KKSB- së, fjala është për zëvendësimin e anëtares Miroslavka Simovic, me znj. Maja Srblljak nga komuniteti serb.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit, propozimi i kryetarit për zëvendësimin e anëtarit të KKSB- së.

Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio-incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës dhe propozime të tjera nuk pati,
Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 11:00 h.

Procesmbajtësi,

z. Avni Gashi

